



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 7, datë 28 .02. 2013

PËR

**“EMËRTIMIN “SKËNDER XHIKU”, TË RRUGËS NGA PRERJA ME RRUGËN
“ARKITEKT SINANI”, DERI NË BRENDËSI TË BLOKUT TË BANIMIT”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “II” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), si dhe nenit 3 të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për emërtimin “Skënder Xhiku”, të rrugës nga prerja me rrugën “Arkitekt Sinani” dhe që vazhdon në brendësi të bllokut të banimit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë emërtimin “Skënder Xhiku”, të rrugës nga prerja me rrugën “Arkitekt Sinani” deri në brendësi të bllokut të banimit” (sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI